



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 384/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.09.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “Shërbim Eliminim mbetjesh të rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.

Ankimues: “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.
Fushë Kuqe, Gurëz, afër ish Kanalit të Acidit, Lezhë

Autoriteti Kontraktor: Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”
Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.04.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “*Sherbim Eleminim mbetjesh te rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar(12 muaj)*”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “*Koço Gliozheni*”.

II.2. Në datën 18.05.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.05.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. “Medi - Tel” sh.p.k. | 4.392.000 lekë, kualifikuar |
| 2. “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. | 4.680.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Eco Riciklim” sh.p.k. | 11.520.000 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 26.05.2020 operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k., si dhe duke ngritur pretendime mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor.

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues ky i fundit pretendon se në datë 28.07.2020 ka marrë dijeni me anë të postës elektronike, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.584 prot, datë 27.05.2020 me objekt “Procesverbal”, me përmbajtje si më poshtë:

[...]

Ankesa juaj u shqyrtua me kujdes dhe u vendos: Te merret parasysh per piken 1 te ankeses tuaj ne lidhje me ofertat anomalisht e ulta nga subjektet:

1. *Medi – Tel me oferte ekonomike 4.392.000 leke pa Tvsh*
2. *V.A.L.E Recycling me oferte ekonomike 4.680.000 pa Tvsh*

Për sa më sipër ju bëjmë me dije se bazuar ne VKM nr.914, datë 29.12.2014 neni 56 te LPP kerkojme nga ana juaj argumentimin e ofertes se paraqitur pasi jeni kualifikuar si oferte e suksesshme dhe oferta juaj rezulton anomalisht e ulet pas perlllogaritjes nga komisioni.

II.6. Në datën 08.06.2020 operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjta pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 30.07.2020, pas verifikimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., KPP merr vendimin 289/2020, datë 30.07.2020, ku vendosi:

1. *Të mos marrë në shqyrtim themelin e ankesës së operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “Sherbim Eliminim mbetjesh te rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë veprimet procedurale sipas nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe të pasqyrojë rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë në Sistemin e Prokurimit Elektronik.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.8. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 25.08.2020 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. "Medi - Tel" sh.p.k. | 4.392.000 lekë, kualifikuar |
| 2. "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. | 4.680.000 lekë, kualifikuar |
| 3. "Eco Riciklim" sh.p.k. | 11.520.000 lekë, skualifikuar |

II.9. Gjithashtu, referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 31.08.2020 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---------------------------------|-------------------------------|
| 1. "Medi - Tel" sh.p.k. | 4.392.000 lekë, kualifikuar |
| 2. "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. | 4.680.000 lekë, kualifikuar |
| 3. "Eco Riciklim" sh.p.k. | 11.520.000 lekë, skualifikuar |

II.10. Në datën 31.08.2020 operatori ekonomik "V.A.L.E. Recycling" sh.p.k. pretendon se ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik "Medi Tel" sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Ndërkohë autoriteti kontraktor në kthim përgjigje deklaroi se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datë 01.09.2020. Konkretisht, operatori ekonomik ankimues ka argumentuar:

"Autoriteti Kontraktor SUOGJ Koco Glozheni (AK), ka njoftuar ne SPE me date 23.04.2020 hapjen e procedurave per realizimin e shërbimit "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore" me fond limit 7.279.200 (shtate milion e dyqind e shtatedhete e nente mije e dyqind) leke pa TVSH. Pasi morem pjese me date 18.05.2020, ne proceduren objekt i kesaj ankese, ne po te njejten date, u njoftuam ne SPE per rezultatet e vleresimit te ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI-TEL</i>	<i>4.392.000</i>	<i>Jo</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>4.680.000</i>	<i>Jo</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>11.520.000</i>	<i>Po</i>

Ne daten 26.05.2020 paraqitem ankese prane autoritetit kontraktor, duke kerkuar nder te tjera edhe zbatimin e nenit 56 te LPP dhe nenit 66 pika 5 te VKM nr.914, date 29.12.2014 ne lidhje me ofertat anomalisht te uleta.

Pas rrezimit te ankeses nga AK, me date 08.06.2020 paraqitern ankese ne KPP, i cili me vendimin m.289/2020 date 30.07.2020, vendosi qe: "Autoriteti kontraktor te kryeje veprimet proceduriale sipas nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe te pasqyroje rivleresimin e ofertave te operateve ekonomike ne Sistemin e Prokurimit Elektronik".

Ne zbatim te vendimit te mesiperme te KPP, AK me date 05.08.2020 na ka derguar kerkese per argumentimin e ofertes anomalisht te ulet, te ciles iu pergjigjem me sqarimet dhe argumentimet e provat perkatese me date 06.08.2020.

Ne vijim, ne date 25.08.2020, u njoftuam ne SPE per rezultatet e rivleresirnit te ofertave nga KVO si vijon:

Operatoret Ekonomike	Vlera e ofertuar	Refuzuar
MEDI-TEL	4.392.000	Jo
V.A.L.E. RECYCLING	4.680.000	Jo
ECO RICIKLIM	11.520.000	Po

Ne i kundershtojme rezultatet e ketij vleresimi per shkaqet dhe me argumentat ne vijim:

1. OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t

AK ka percaktuar ne piken 2.3.4. te Kapacitetit Teknik se:

Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i paisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:

Pajisur me certifikate:

- Certifikate SSH/EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit te Cilesise,
- Certifikate SSH/EN ISO 14001:2015 Per sistemin e Menaxhimit te Mjedisit,
- Certifikate BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 Per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune.

Ne Zbatim te te rekomandimit te APP dhe DPA date 20.03.2018, te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilesise Jane te akredituar nga DPA, ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika E Shqiperise.

Nga eksperienca jone dhe konsultimet me eksperte te certifikimit ISO, qe nje certifikate ISO te konsiderohet e vlefshme, kur ka kaluar nje vit apo me shume nga momenti i leshimit te saj, ajo duhet gjithmone te shoqerohet me konfirmimin e vlefshmerise vjetore, pra ti jete nenshtruar auditimit vijues vjetor qe konfirmon vlefshmerine e Certifikimit ISO perkates.

Nga vendimi 264\2020 i Komisioni te Prokurimit Publik (bashkelidhur) rezulton qe OE MEDI-TEL edhe ne kliente private te ndryshem, nuk i shoqeron Certifikatat ISO te veta me konfirmimin vjetor te vlefshmerise pra me konfirmimin e auditimit vijues vjetor.

Nga disa akte administrative te procedurave te tjera (vendimi 264\2020 i Komisioni te Prokurimit Publik), qe tashme jane bere publike, konstatojme se ne daten e pranimit te ofertave, OE MEDI-TEL ka paraqitur Certifikaten ISO 9001:2015 nr. 1118/15 leshuar ne daten 07.09.2018, dhe Certifikaten/Iso 14001:2015 nr.544/15 leshuar ne daten 07.09.2018 ne te cilat ne shenimet ne fund te certifikates percaktohet se: "Vlefshmeria e certifikates eshte subjekt i ekzekutimit te Auditeve vjetore te mbikeqyrjes".

Pra, rezulton se OE MEDI-TEL nuk ka paraqitur asnje dokument qe te konfirmoje se auditimet vjetore per keto certifikata jane kryer prej Trupes Certifikuese dhe jane kaluar me sukses. Kjo dmth se nga ky OE nuk eshte paraqitur prove se keto certifikata jane te konfirmuara per vlefshmerine nga data 07.09.2019 e ne vijim, pra me kryerjen e auditit vjetor te radhes.

OE MEDI-TEL pretendon se KVO duhet te kishte konsultuar organizmin e certifikimit per te verifikuar vlefshmerine e certifikates.

Saktesojme se ne piken 2.3.4, te shtojces 7, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST, specifikisht eshte percaktuar qe "te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme ... ". Pra, AK ka

parashikuar dhe ka kerkuar qe jane vete OE ata qe duhet te parqesin prova te plota per vlefshmerine e certifikatave.

Rregullat dhe procedurat ISO percaktojne qe pavaresisht nga periudha totale e vlefshmerise se certifikates ISO, mbajtesit e tyre duhet ti nenshtrohen rregullisht nje auditimi te mbikeqyrjes te pakten cdo 12 muaj, per te konfirmuar qe standartet e certifikuara jane te permbushura. Mund te ndodhe, qe Trupa Certifikuese, te mos e konfirmoje vlefshmerine e Certifikates pas auditimit vjetor, dhe pergjegjesia per te provuar qe kjo nuk ka ndodhur, pra qe Certifikatat jane te vlefshme, i takon OE ofertues.

Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe Jodiskriminuese. "Gjithashtu ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ... ". Ne Dokumentat Standarte te Tenderit, pika II, "Udhezime per operatoret ekonomike", Seksioni 1 "Hartimi i ofertes", pika 1.1, thuhet: "Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT. Ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto DT do te refuzohen si te papranueshme ".

LPP dhe rregullat e prokurimit publik percaktojne qarte se mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme, si dhe perben kusht per skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, pra nga gara, sic percaktohet ne paragrafin e fundit te Shtojces 7, te DST.

Per kete arsye, ne zbatim te LPP dhe rregullave te prokurimit, nuk mund kualifikohet nje operator ekonomik ne rast se ai ka paraqitur dokumentacion te paplote sipas kritereve te percaktuara nga vete autoriteti kontraktor. Keto qendrime te ligjit dhe te rregullave te prokurimit, sa i takon trajtimin te kesaj ceshtje, kane rendesine e tyre te madhe per zhvillimin e nje procedure konkurruese prokurimi, pasi ato jane garante te zhvillimit te nje gare te barabarte mes paleve (neni 2 i LPP-se).

Ne rrethanat e mesiperme, Certifikatat ISO te OE MEDI-TEL nuk mund te konsiderohen te vlefshme, ndaj kjo perben shkak per skualifikim, pasi vete AK ka percaktuar qe Certifikatat ISO duhet te jene "te vlefshme".

Ne konkluzion: Kerkojme qe OE MEDI-TEL te skualifikohet, pasi nuk permbush piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t.

2. OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me kontraten me landfillin (sic rezulton ne vendimin 264\2020, date 22/07/2020 te Komisionit te Prokurimit Publik). Ak ne DST ne kriterin 2.3.6 te Kapacitetit Teknik ka percaktuar se: "Operatori Ekonomik duhet te lidhe nje kontrate me nje landfill te licensuar per depozitimin e produktit final e cila duhet te jete aktive ne momentin e shpalljes fitues te subjektit, kjo bazuar ne ligjin nr. 10463 date 22/09/2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"

Per permbushjen e ketij kriteri, OE MEDI-TEL ka paraqitur Akt - Marreveshje te lidhur me INTEGRATED TECHNOLOGY BV SPV sh.p.k. me date 15.01.2020, ku ne fq.l percaktohet: "... Kjo akt marreveshje 1 (nje) vjecare, me vlefshmeri per nje muaj dhe e rinovueshme cdo muaj. Ne

rast mosrinovimi, kjo akt marreveshje e humbet vleren e saj ne teresi." OE MEDI-TEL nuk ka paraqitur se bashku me Akt Marreveshjen, ndonje prove per rinovimin e saj pertej dates 16.02.2020, pra kjo akt marreveshje konsiderohet jo e vlefshme dhe jo aktive ne daten e hapjes se ofertave 18.05.2020, si dhe nuk shoqerohet me asnje prove qe garanton qe ne momentin e shpalljes fitues te subjektit, OE MEDI-TEL gezon serish munesine per te kontraktuar me subjektin operues te Landfillit. Akt Marreveshja ne fjale, nuk shprehet per rinovim automatik te kontrates, por per vlefshmeri njemujore me mundesi rinovimi, per me teper duke saktësuar se ne rast mosrinovimi. akt marreveshja e humbet vleren e saj ne teresi. Pra, rinovimi nuk eshte automatik, por duhet te jete i shprehur, ne te njejten linje mendimi shprehet dhe Komisioni i Prokurimit publik ne vendimin 264\2020, date 22/07/2020.

Ne sa me siper, si dhe duke patur parasysh kerkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, si dhe precedentin e krijuar nga Vendimi i Komisionit te Prokurimit Publik rezulton se OE MEDI-TEL, ka deshtuar te permbushë kerkesen e autoritetit kontraktor per te paraqitur dokumentacionin e nevojshem, qe provon se kontrata e lidhur me nje landfill per depozitim e produktin final, do te jete e vlefshme dhe aktive ne momentin e shpalljes fitues te subjektit.

Ne konkluzion: Kerkojme qe OE MEDI-TEL te skualifikohet, pasi nuk permbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me kontraten me landfillin.

Sa me siper, tregon se operatori ekonomik nuk ka permbushur kriteret per keto pika dhe ne keto kushte AK-ja nuk mund ta kualifikoje oferten e tij si te vlefshme.

3. OE MEDI TEL nuk ka mundesi reale te justifikojë vleren e ofertes anomalisht te ulet te paraqitur prej tij. Duke e njohur mire tregun dhe analizen e detajuar te kostove per realizimin e ketij sherbimi, ne kemi vezhguar dhe studiuar edhe modalitetet me te cilat operon OE MEDI-TEL.

Nga keto vezhgime, na rezulton se OE MEDI-TEL, nuk ka kushte favorizuese si tonat, ne lidhje me elementet ekonomike si p.sh. (i) vlerat favorizuese ne fumizimin me materiale per shkak te rritjes se volumit te shitjeve MEDI-TEL ne fakt ka pesuar renie ne volumin e shitjeve, sic mund te shikohet ne bilancet e depozituara dhe te pasqyruara ne faqen ëeb te QKR); (ii) nuk e ben servisimin teknik te automjeteve ne stabilimentin e vet dhe me burimet e veta teknike dhe njerezore por tek te trete, cka i shkakton kosto me te larta se tonat; (iii) kostot e karburantit i ka me te larta, pasi ndryshe nga ne nuk ka bot dhe pike fumizimi ne stabilimentin e vet qe mundeson perfitimin e karburantit me cmim favorizues; etj.

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, rezulton se barra e proves mbi argumentin e ofertes anomalisht te ulet i perket operatorit ekonomik, oferta e te cilit eshte konstatuar anomalisht e ulet nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave.

Argumentimi i ofertes anomalisht te ulet njeherazi duhet te plotesoje kater kushte kumulative per ti dhene garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Se pari, operatori ekonomik ankimes duhet te dorezoje ne menyre te detajuar anen ekonomike te metodës se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara, gjithashtu duhet te paraqese para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike te ofruara si edhe ne raste te vecanta dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve. Gjithashtu OE duhet te argumentojne ne lidhje me origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi, si edhe mbi zbatueshrnerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi.

Sipas nenit 56 te LPP eshte detyre e operatoreve ekonomike oferta e te cileve eshte konstatuar anomalisht e ulet te paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor ne lidhje me plotesimin e kater kushtet e mesiperme, te cilat jane kushte kumulative dhe argumentimi i secilit prej tyre duhet provuar nga OE perkates me ane te provave shkresore dhe sqarimeve perkatese.

Risku qe shfaqet ne rast se nje oferte rezulton anomalisht e ulet eshte ne disa drejtime ku nder te tjera si: rreziku per mos kryerjen e sherbirnit/puneve ne cilesine e duhur; rreziku i terheqjes se operatorit ekonomik nga lidhja e kontrates dhe kosto qe i linden autoritetit nga mos kryerja e sherbimit brenda afateve kohore te parashikuara; humbjet qe mund te pesoje ne kohe nga mos kryerja e sherbimit gjate periudhes se ri publikimit te procedures se tenderit ne rast te mos zbatimit te kontrates nga ana e operatorit ekonomik oferta e te cilit rezulton anomalisht e ulet.

Referuar nenit 1 germa "b" "Objekti dhe qellimi" i ligj it nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Objekt i ketij ligji eshte percaktimi i rregullave qe zbatohen per prokurimet e mallrave, te puneve dhe te sherbimeve nga autoritetet kontraktore, te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; Mireperdorirni i fondeve publike perfshin jo vetem perzgjedhjen nga autoriteti kontraktor te ofertave me te uleta (si kriter I perzgjedhjes se ofertes fituese referuar cmimit me te ulet"), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe deshtimin e kontrates qe mund te vijne nga oferta te cilesuar si anomalisht te uleta, referuar formules se perllogaritjes te parashikuar ne ligj.

Bazuar ne njohjet tona te ketij OE, na rezulton se nuk mund te jene paraqitur prova me te dhena, fakte apo garanci qe te justifikojne vleren e ofruar prej ketij OE, sipas kerkesave te nenit 56 te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

Duke qene se provueshmeria e ketij kriteri eshte esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetem per realizimin e sherbimeve, por per realizimin e tyre sipas standarteve te kerkuara ne cilesi dhe sasi dhe me cmimin konkurues te ofertuar. Bazuar ne arsyetimin e shtjelluar me lart, mendojme se nga OE MEDI-TEL jane paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo bindes qe te argumentojne oferten anomalisht te ulet (ne kuptim te: metodet se perzgjedhur, zgjidhjeve teknike te posacme, kushte perjashtimisht favorizuese qe gezon ofertuesi apo origjinaliteti i punes se propozuar).

Ne konkluzion: Oferta e OE MEDI-TEL. duhet te refuzohet pasi nuk krijon bindjen se kjo oferte eshte e rregullt ne te gjithë elementet e saj me qellim garantimin e nje kontrate te suksesshme.

Gjithashtu theksojme se KVO duhet te jete me e pergjegjshme, e sakte dhe kujdesshme, pasi ka krijuar konfuzion ne realizimin e procedures, duke derguar dy here kerkesa per argumentim te ofertes anomalisht te ulet dhe duke nxjerre dy here njoftim rivleresirni ne SPE.

II.11. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.923/4 prot, datë 03.09.2020, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar atë.

II.12. Në datën 11.09.2020 operatori ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

“Autoriteti Kontraktor SUOGJ Koco Glozheni (AK), ka njoftuar ne SPE me date 23.04.2020 hapjen e procedurave per realizimin e sherbimit "Evadimi i mbetjeve te rrezikshme spitalore" me fond limit 7.279.200 (shtate milion e dyqind e shtatedhete e nente mije e dyqind) leke pa TVSH.

Pasi morem pjese me date 18.05.2020, ne proceduren objekt i kesaj ankese, ne po te njejten date, u njoftuam ne SPE per rezultatet e vleresimit te ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI-TEL</i>	<i>4.392.000</i>	<i>Jo</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>4.680.000</i>	<i>Jo</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>11.520.000</i>	<i>Po</i>

Ne daten 26.05.2020 paraqitem ankese prane autoritetit kontraktor, duke kerkuar nder te tjera edhe zbatimin e nenit 56 te LPP dhe nenit 66 pika 5 te VKM nr.914, date 29.12.2014 ne lidhje me ofertat anomalisht te uleta.

Pas rrezimit te ankeses nga AK, me date 08.06.2020 paraqitem ankese ne KPP, i cili me vendimin m.289/2020 date 30.07.2020, vendosi qe: "Autoriteti kontraktor te kryeje veprimet procedurale sipas nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe te pasqyroje rivleresimin e ofertave te operatoreve ekonomike ne Sistemin e Prokurimit Elektronik". Ne zbatim te vendimit te mesiperme te KPP, AK me date 05.08.2020 na ka derguar kerkese per argumentimin e ofertes anomalisht te ulet, te ciles iu pergjigjem me sqarimet dhe argumentimet e provat perkatese me date 06.08.2020.

Ne vijim, ne date 25.08.2020, u njoftuam ne SPE per rezultatet e rivleresimit te ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI-TEL</i>	<i>4.392.000</i>	<i>Jo</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>4.680.000</i>	<i>Jo</i>
<i>ECO RICIKLIM</i>	<i>11.520.000</i>	<i>Po</i>

Ne date 31.08.2020, u njoftuam ne SPE perseri per rezultatet e rivleresimit te ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>MEDI-TEL</i>	<i>4.392.000</i>	<i>Jo</i>
<i>V.A.L.E. RECYCLING</i>	<i>4.680.000</i>	<i>Jo</i>
<i>ECO RICIKLINI</i>	<i>11.520.000</i>	<i>Po</i>

Pas ankesës nga ana jonë për rivlerësimet e sipërpërmendura, AK refuzon ankesën me pretendimin se ka respektuar të gjitha udhëzimet e APP dhe vendimin e KPP, duke mos u thelluar në asnjë nga pretendimet konkrete të ngritura nga OE V.A.L.E Recycling.

Ne i kundërshtojme rezultatet e ketij vleresimi per shkaqet dhe me argumentat ne vijim:

1. OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t AK ka percaktuar ne piken 2.3.4. te Kapacitetit Teknik se:

Operatori Ekonomik ofertues duhet te jete i paisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme sipas objektit qe prokurohet, si me poshte:

Pajisur me certifikate:

- Certifikate SSH/EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit te Cilesise,*
- Certifikate SSH/EN ISO 14001:2015 Per sistemin e Menaxhimit te Mjedisit,*
- Certifikate BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 Per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune.*

Ne Zbatim te te rekomandimit te APP dhe DPA date 20.03.2018, te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilesise

Jane te akredituar nga DPA, ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika E Shqiperise.

Nga eksperienca jone dhe konsultimet me eksperte te certifikimit ISO, qe nje certifikate ISO te konsiderohet e vlefshme, kur ka kaluar nje vit apo me shume nga momenti i leshimit te saj, ajo duhet gjithmone te shoqerohet me konfirmimin e vlefshmerise vjetore, pra ti jete nenshtuar auditimit vijues vjetor qe konfirmon vlefshmerine e Certifikimit ISO perkates.

Nga vendimi 264\2020 i Komisioni te Prokurimit Publik (bashkelidhur) rezulton qe OE MEDI-TEL edhe ne kliente private te ndryshem, nuk i shoqeron Certifikatat ISO te veta me konfirmimin vjetor te vlefshmerise pra me konfirmimin e auditimit vijues vjetor.

Nga disa akte administrative te procedurave te tjera (vendimi 264\2020 i Komisioni te Prokurimit Publik), qe tashme jane bere publike, konstatojme se ne daten e pranimi te ofertave, OE MEDI-TEL ka paraqitur Certifikaten ISO 9001:2015 nr. 1118/15 leshuar ne daten 07.09.2018, dhe Certifikaten/Iso 14001:2015 nr.544/15 leshuar ne daten 07.09.2018 ne te cilat ne shenimet ne fund te certifikates percaktohet se: "Vlefshmeria e certifikates eshte subjekt i ekzekutimit te Auditeve vjetore te mbikeqyrjes".

Pra, rezulton se OE MEDI-TEL nuk ka paraqitur asnje dokument qe te konfirmoje se auditimet vjetore per keto certifikata jane kryer prej Trupes Certifikuese dhe jane kaluar me sukses. Kjo dmth se nga ky OE nuk eshte paraqitur prove se keto certifikata jane te konfirmuara per vlefshmerine nga data 07.09.2019 e ne vijim, pra me kryerjen e auditit vjetor te radhes.

OE MEDI-TEL pretendon se KVO duhet te kishte konsultuar organizmin e certifikimit per te verifikuar vlefshmerine e certifikates.

Saktesojme se ne piken 2.3.4, te shtojces 7, Kriteret e vecanta te kualifikimit, te DST, specifikisht eshte percaktuar qe "te gjitha certifikatat e cilesise duhet te jene te vlefshme ... ". Pra, AK ka parashikuar dhe ka kerkuar qe jane vete OE ata qe duhet te parqesin prova te plota per vlefshmerine e certifikatave.

Rregullat dhe procedurat ISO percaktojne qe pavaresisht nga periudha totale e vlefshmerise se certifikates ISO, mbajtesit e tyre duhet ti nenshtrohen rregullisht nje auditimi te mbikeqyrjes te pakten cdo 12 muaj, per te konfirmuar qe standartet e certifikuara jane te permbushura. Mund te ndodhe, qe Trupa Certifikuese, te mos e konfirmoje vlefshmerine e Certifikates pas auditimit vjetor, dhe pergjegjesia per te provuar qe kjo nuk ka ndodhur, pra qe Certifikatat jane te vlefshme, i takon OE ofertues.

Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe Jodiskriminuese. "Gjithashtu ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ... ". Ne Dokumentat Standarte te Tenderit, pika II, "Udhezime per operatoret ekonornike", Seksioni 1 "Hartimi i ofertes", pika 1.1, thuhet: "Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne keto DT. Ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto DT do te refuzohen si te papranueshme ".

LPP dhe rregullat e prokurimit publik percaktojne qarte se mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme, si dhe perben kusht per skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, pra nga gara, sic percaktohet ne paragrafin e fundit te Shtojces 7, te DST.

Per kete arsye, ne zbatim te LPP dhe rregullave te prokurimit, nuk mund kualifikohet nje operator ekonomik ne rast se ai ka paraqitur dokumentacion te paplote sipas kriterëve te percaktuara nga vete autoriteti kontraktor. Keto qendrime te ligjit dhe te rregullave te prokurimit, sa i takon trajtimin te kesaj ceshtje, kane rendesine e tyre te madhe per zhvillimin e nje procedure konkurruese prokurimi, pasi ato jane garante te zhvillimit te nje gare te barabarte mes paleve (neni 2 i LPP-se).

Ne rrethanat e mesiperme, Certifikatat ISO te OE MEDI-TEL nuk mund te konsiderohen te vlefshme, ndaj kjo perben shkak per skualifikim, pasi vete AK ka percaktuar qe Certifikatat ISO duhet te jene "te vlefshme".

Ne konkluzion: Kerkojme qe OE MEDI-TEL te skualifikohet, pasi nuk permbush piken 2.3.4 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me ISO-t.

2. OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me kontraten me landfillin (sic rezulton ne vendimin 264\2020, date 22/07/2020 te Komisionit te Prokurimit Publik). Ak ne DST ne kriterin 2.3.6 te Kapacitetit Teknik ka percaktuar se: "Operatori Ekonomik duhet te lidhe nje kontrate me nje landfill te licensuar per depozitimin e produktit final e cila duhet te jete aktive ne momentin e shpalljes fitues te subjektit, kjo bazuar ne ligjin nr. 10463 date 22/09/2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"

Per permbushjen e ketij kriteri, OE MEDI-TEL ka paraqitur Akt - Marreveshje te lidhur me INTEGRATED TECHNOLOGY BV SPV sh.p.k. me date 15.01.2020, ku ne fq.1 percaktohet: "... Kjo akt marreveshje 1 (nje) vjecare, me vlefshmeri per nje muaj dhe e rinovueshme cdo muaj. Ne rast mosrinovimi, kjo akt marreveshje e humbet vleren e saj ne teresi." OE MEDI-TEL nuk ka paraqitur se bashku me Akt Marreveshjen, ndonje prove per rinovimin e saj pertej dates 16.02.2020, pra kjo akt marreveshje konsiderohet jo e vlefshme dhe jo aktive ne daten e hapjes se ofertave 18.05.2020, si dhe nuk shoqerohet me asnje prove qe garanton qe ne momentin e shpalljes fitues te subjektit, OE MEDI-TEL gezon serish munesine per te kontraktuar me subjektin operues te Landfillit. Akt Marreveshja ne fjale, nuk shprehet per rinovim automatik te kontrates, por per vlefshmeri njemujore me mundesi rinovimi, per me teper duke saktësuar se ne rast mosrinovimi. akt marreveshja e humbet vleren e saj ne teresi. Pra, rinovimi nuk eshte automatik, por duhet te jete i shprehur, ne te njejten linje mendimi shprehet dhe Komisioni i Prokurimit publik ne vendimin 264\2020, date 22/07/2020.

Ne sa me siper, si dhe duke patur parasysh kerkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit, si dhe precedentin e krijuar nga Vendimi i Komisionit te Prokurimit Publik rezulton se OE MEDI-TEL, ka deshtuar te permbushë kerkesen e autoritetit kontraktor per te paraqitur dokumentacionin e nevojshem, qe provon se kontrata e lidhur me nje landfill per depozitimin e produktin final, do te jete e vlefshme dhe aktive ne momentin e shpalljes fitues te subjektit.

Ne konkluzion: Kerkojme qe OE MEDI-TEL te skualifikohet, pasi nuk permbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik ne lidhje me kontraten me landfillin.

Sa me siper, tregon se operatori ekonomik nuk ka permbushur kriteret per keto pika dhe ne keto kushte AK-ja nuk mund ta kualifikoje oferten e tij si te vlefshme.

3. OE MEDI TEL nuk ka mundesi reale te justifikojte vleren e ofertes anomalisht te ulet te paraqitur prej tij. Duke e njohur mire tregun dhe analizen e detajuar te kostove per realizimin e ketij sherbimi, ne kemi vezhguar dhe studiuar edhe modalitetet me te cilat operon OE MEDI-TEL.

Nga keto vezhgime, na rezulton se OE MEDI-TEL, nuk ka kushte favorizuese si tonat, ne lidhje me elementet ekonomike si p.sh. (i) vlerat favorizuese ne fumizimin me materiale per shkak te rritjes se volumit te shitjeve MEDI-TEL ne fakt ka pesuar renie ne volumen e shitjeve, sic mund te shikohet ne bilancet e depozituara dhe te pasqyruara ne faqen eeb te QKR); (ii) nuk e ben servisimin teknik te automjeteve ne stabilimentin e vet dhe me burimet e veta teknike dhe njerezore por tek te trete, cka i shkakton kosto me te larta se tonat; (iii) kostot e karburantit i ka me te larta, pasi ndryshe nga ne nuk ka bot dhe pike fumizimi ne stabilimentin e vet qe mundeson perfitimin e karburantit me cmim favorizues; etj.

Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, rezulton se barra e proves mbi argumentin e ofertes anomalisht te ulet i perket operatorit ekonomik, oferta e te cilit eshte konstatuar anomalisht e ulet nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave.

Argumentimi i ofertes anomalisht te ulet njeherazi duhet te plotesoje kater kushte kumulative per ti dhene garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Se pari, operatori ekonomik ankimues duhet te dorezoje ne menyre te detajuar anen ekonomike te metodet se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara, gjithashtu duhet te paraqese para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike te ofruara si edhe ne raste te vecanta dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve. Gjithashtu OE duhet te argumentojne ne lidhje me origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi, si edhe mbi zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. Sipas nenit 56 te LPP eshte detyre e operatoreve ekonomike oferta e te cileve eshte konstatuar anomalisht e ulet te paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor ne lidhje me plotesimin e kater kushtet e mesiperme, te cilat jane kushte kumulative dhe argumentimi i secilit prej tyre duhet provuar nga OE perkates me ane te provave shkresore dhe sqarimeve perkatese.

Risku qe shfaqet ne rast se nje oferte rezulton anomalisht e ulet eshte ne disa drejtime ku nder te tjera si: rreziku per mos kryerjen e sherbirnit/puneve ne cilesine e duhur; rreziku i terheqjes se operatorit ekonomik nga lidhja e kontrates dhe kosto qe i lindin autoritetit nga mos kryerja e sherbimit brenda afateve kohore te parashikuara; humbjet qe mund te pesoje ne kohe nga mos kryerja e sherbimit gjate periudhes se ri publikimit te procedures se tenderit ne rast te mos zbatimit te kontrates nga ana e operatorit ekonomik oferta e te cilit rezulton anomalisht e ulet.

Referuar nenit 1 germa "b" "Objekti dhe qellimi" i ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "Objekt i ketij ligji eshte percaktimi i rregullave qe zbatohen per prokurimet e mallrave, te puneve dhe te sherbimeve nga autoritetet kontraktore, te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; Mireperdorirni i fondeve publike perfshin jo vetem perzgjedhjen nga autoriteti kontraktor te ofertave me te uleta (si kriter I perzgjedhjes se ofertes fituese referuar cmimit me te ulet"), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe deshtimin e kontrates qe mund te vijne nga oferta te cilesuar si anomalisht te uleta, referuar formulese se perlllogaritjes te parashikuar ne ligj.

Bazuar ne njohjet tona te ketij OE, na rezulton se nuk mund te jene paraqitur prova me te dhena, fakte apo garanci qe te justifikojne vleren e ofruar prej ketij OE, sipas kerkesave te nenit 56 te Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar.

Duke qene se provueshmeria e ketij kriteri eshte esenciale duke garantuar autoritetin kontraktor jo vetem per realizimin e sherbimeve, por per realizimin e tyre sipas standarteve te kerkuara ne cilesi dhe sasi dhe me cmimin konkurues te ofertuar. Bazuar ne arsyetimin e shtjelluar me lart, mendojme se nga OE MEDI-TEL jane paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo bindes qe te argumentojne oferten anomalisht te ulet (ne kuptim te: metodet se perzgjedhur, zgjidhjeve teknike te posacme, kushte perjashtimisht favorizuese qe gezon ofertuesi apo origjinaliteti i punes se propozuar).

Ne konkluzion: Oferta e OE MEDI-TEL. duhet te refuzohet pasi nuk krijon bindjen se kjo oferte eshte e rregullt ne te gjithë elementet e saj me qellim garantimin e nje kontrate te suksesshme.

Gjithashtu theksojme se KVO duhet te jete me e pergjegjshme, e sakte dhe kujdesshme, pasi ka krijuar konfuzion ne realizimin e procedures, duke derguar dy here kerkese per argumentim te ofertes anomalisht te ulet dhe duke nxjerre dy here njoftim rivleresirni ne SPE.”

Kemi dorezuar ankesen perkatese prane AK me date 01.09.2020 protokolluar ne AK me nr.923 (Shtojca 4). AK ka kthyer pergjigje per ankesen tone me shkresen nr.923/4 date 03.09.2020 ku ka bashkelidhur dhe procesverbalin e shqyrtimit te ankeses nr.923/3 date 03.09.2020, te marre ne dorezim nga ana jone me date 04.09.2020 (Shtojca 5).

AK ne pergjigjen e vet, ne menyre teresisht te kundraligjshme ka vendosur te mos marre ne shqyrtim ankesen tone, me pretendimin se ka pasur per kete ceshtje, nje Vendim te KPP, nderkohe qe ne te vertete, Vendimi i KPP nr. 289/2020 date 30.07.2020, nuke ka marre ne shqyrtim ankesen tone ne ate rast, por ka vendosur qe; "Autoriteti kontraktor te kryeje veprimet proceduriale sipas nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20. 11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, dhe te pasqyroje rivleresimin e ofertave te operatoreve ekonomike ne Sistemin e Prokurimit Elektronik".

Pra, ne menyre teresisht te kundraligjshme, AK ka refuzuar te kryeje detyrat e veta qe i ngarkon Neni 63 i LPP dhe nuk ka rnarre ne shqyrtim ankesen tone, qe ka te beje me rivleresimin dhe jo me vleresimin e pare te kryer nga AK. Ne konkluzion,

Ne konkluzion, duke u nisur nga sa me siper, kerkojme shqyrtimin e ankeses sone, shfuqizimin e vendimit te KVO per rivleresimin e dates 25.08.2020 (dhe 31.08.2020), Vendimin e KSHA te dates 03.09.2020 dhe rivleresimin perkates, duke u skualifikuar OE MEDI-TEL, per arsyet e shtjelluara ne kete ankesë.

Gjithashtu kerkojme qe KPP te referoje ne APP per fillim te procedimit dhe hetimit administrativ zyrtaret e AK per te gjitha shkeljet proceduriale te kryera gjate zhvillimit te kesaj procedure.

II.13. Nëpërmjet shkresës nr. 974/1 prot., datë 16.09.2020, protokolluar me tonën në datën 16.09.2020, me objekt “Përgjigje për zbatimin e Vendimit nr.1103/1 prot., datë 15.09.2020 (Prot nga ana jonë me nr. 652 dt 15.09.2020”, si dhe shkresës nr. 981 prot., datë 17.09.2020, protokolluar me tonën në datën 17.09.2020, me objekt “Dërgim dokumentacioni shtesë në lidhje me subjektin “Medi Tel” sh.p.k.”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi – Tel” sh.p.k. me pretendimin se “...Nga eksperiencia jone dhe konsultimet me eksperte te certifikimit ISO, qe nje certifikate ISO te konsiderohet e vlefshme, kur ka kaluar nje vit apo me shume nga momenti i leshimit te saj, ajo duhet gjithmone te shoqerohet me konfirmimin e vlefshmerise vjetore, pra ti jete nenshtruar auditimit vijues vjetor qe konfirmon vlefshmerine e Certifikimit ISO perkates.....[...] Pra, rezulton se OE MEDI-TEL nuk ka paraqitur asnje dokument qe te konfirmoje se auditimet vjetore per keto certifikata jane kryer prej Trupes Certifikuese dhe jane kaluar me sukses. Kjo dmth se nga ky OE nuk eshte paraqitur prove se keto certifikata jane te konfirmuara per vlefshmerine nga data 07.09.2019 e ne vijim, pra me kryerjen e auditit vjetor te radhes...[...]. Ne rrethanat e mesiperme, Certifikatat ISO te OE MEDI-TEL nuk mund te konsiderohen te vlefshme, ndaj kjo perben shkak per skualifikim, pasi vete AK ka percaktuar qe Certifikatat ISO duhet te jene "te vlefshme".”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.4 “Për kapacitetin teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.4. *Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme sipas objektit që prokurohet, si më poshtë:*

Pajisur me certifikate:

- Çertifikatë SSH/EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë,
- Çertifikatë SSH/EN ISO 14001:2015 Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit,
- Çertifikatë BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Punë.

Në Zbatim të të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018 , të gjitha certifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika E Shqipërisë .

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Certificate Nr. 1118/15 UNE-EN ISO 9001:2015, i vlefshëm për fushën e mëposhtme të aplikimit “Grumbullim, Transport, Trajtim i Mbetjeve Spitalore dhe Medikamenteve, Dezinfektim Mjedisesh Spitalore, Industriale dhe Ushqimore”, lëshuar nga ICDQ Instituto de Certifikation.
- Certificate Nr. 544/15 UNE-EN ISO 14001:2015, i vlefshëm për fushën e mëposhtme të aplikimit “Grumbullim, Transport, Trajtim i Mbetjeve Spitalore dhe Medikamenteve, Dezinfektim Mjedisesh Spitalore, Industriale dhe Ushqimore”, lëshuar nga ICDQ Instituto de Certifikation.
- Certificate Nr. 089/17 SCR, BS OHSAS 18001:2007, i vlefshëm për fushën e mëposhtme të aplikimit “Grumbullim, Transport, Trajtim i Mbetjeve Spitalore dhe Medikamenteve, Dezinfektim Mjedisesh Spitalore, Industriale dhe Ushqimore”, lëshuar nga ICDQ Certifikim Cilësie, (shoqëruar me Konfirmim vlefshmërie certifikate nr.089/17 SCR date 06.06.2017 për auditin e mirëmbajtjes së II).

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/a e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;[...]”*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.4. Në nenin 28, pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) “Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin

ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. me argumentin se ky i fundit nuk ka paraqitur çertifikatat e kërkuara të shoqëruara me konfirmimin e vlefshmërisë vjetore, pra ti jetë nënshtruar auditimit vijues vjetor që konfirmon vlefshmërinë e Certifikimit ISO përkatës, KPP sqaron se, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.4 *“Për kapacitetin teknik”*, të dokumentave të tenderit ka përcaktuar shprehimisht se *“2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur dhe të paraqesë çertifikatat përkatëse të vlefshme sipas objektit që prokurohet, si më poshtë: Pajisur me çertifikate:*

- *Çertifikatë SSH/EN ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë,*
- *Çertifikatë SSH/EN ISO 14001:2015 Për sistemin e Menaxhimit të Mjedisit,*
- *Çertifikatë BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Punë.*

Në Zbatim të të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018 , të gjitha çertifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika E Shqipërisë”. Në një interpretim literal të kriterit të mësipërm, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesën që të gjitha çertifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë janë të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika E Shqipërisë, pa kërkuar ndonjë dokument tjetër vlefshmërie si auditimi vijues vjetor, sic pretendon operatori ekonomik ankimues. Pra, sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. është një pretendim i cili bazohet mbi një kriter të pakërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, kështu që rrjedhimisht kërkesa e tij është një kërkesë e pabazuar dhe nuk qëndron.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm*

mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi – Tel” sh.p.k. me pretendimin se “...*OE MEDI-TEL nuk ploteson piken 2.3.6 të Kapacitetit Teknik në lidhje me kontratën me landfillin (sic rezulton në vendimin 264\2020, date 22/07/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik). Ak në DST në kriterin 2.3.6 të Kapacitetit Teknik ka percaktuar se: "Operatori Ekonomik duhet të lidhë një kontratë me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final e cila duhet të jetë aktive në momentin e shpalljes fitues të subjektit, kjo bazuar në ligjin nr. 10463 date 22/09/2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Për përmbushjen e këtij kriteri, OE MEDI-TEL ka paraqitur Akt - Marreveshje të lidhur me INTEGRATED TECHNOLOGY BV SPV sh.p.k. me date 15.01.2020, ku në fq.1 percaktohet: ".... Kjo akt marreveshje 1 (një) vjecare, me vlefshmeri për një muaj dhe e rinovueshme çdo muaj. Në rast mosrinovimi, kjo akt marreveshje e humbet vlerën e saj në teresi." OE MEDI-TEL nuk ka paraqitur se bashku me Akt Marreveshjen, ndonjë prove për rinovimin e saj përtej dates 16.02.2020, pra kjo akt marreveshje konsiderohet jo e vlefshme dhe jo aktive në datën e hapjes së ofertave 18.05.2020, si dhe nuk shoqërohet me asnjë prove që garanton që në momentin e shpalljes fitues të subjektit, OE MEDI-TEL gëzon serish munesinë për të kontraktuar me subjektin operues të Landfillit. Akt Marreveshja në fjalë, nuk shprehet për rinovim automatik të kontratës, por për vlefshmeri njëmuajore me mundësi rinovimi, për me teper duke saktësuar se në rast mosrinovimi. akt marreveshja e humbet vlerën e saj në teresi. Pra, rinovimi nuk është automatik, por duhet të jetë i shprehur, në të njëjten linjë mendimi shprehet dhe Komisioni i Prokurimit publik në vendimin 264\2020, date 22/07/2020.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “*Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*”

III.2.2. Neni 63, pika 2, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “*Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*”

III.2.3. Neni 63, pika 5, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “*Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.*”

III.2.4. Ndërsa Neni 63, pika 6, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”*.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga KPP, nëpërmjet ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k, si dhe informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor, rezulton se operatori ekonomik ankimes, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datë 26.05.2020 për vendimin e marrë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datë 18.05.2020, në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi – Tel” sh.p.k., ankesë e cila është refuzuar nga autoriteti kontraktor, por në datë 08.06.2020 operatori ekonomik ankimes në respekt të shkallëve të ankimit, ka paraqitur ankesë pranë KPP në datë 08.06.2020, ankesë për të cilin KPP ka dalë me vendimin KPP 289/2020 datë 30.07.2020.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor, në zbatim të vendimit të KPP 289/2020, në datën 25.08.2020 ka kryer rivlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Në rastin konkret, për sa i përket pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimes, KPP sqaron se, operatorit ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k. për asnjë moment nuk e ka ngritur pretendimin e mësipër, si mungesë të dokumentacionit të operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k., që në momentin e parë kur ka kundërshtuar kualifikimin e këtij operatori në vlerësimin e datës 18.05.2020, por e ka ngritur këtë pretendim pas rivlerësimit të kësaj procedure prokurimi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, LPP parashikon në mënyrë eksplicite se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, fillimisht operatorët ekonomike që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e ankimit pranë autoritetit kontraktor brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjithë elementët formal sipas dispozitave ligjore. Operatori ekonomik ankimes “V.A.L.E Recycling” sh.p.k, ka paraqitur ankesë në datë 26.05.2020, pranë autoritetit kontraktor për vlerësimin e parë të kryer nga KVO në datën 18.05.2020, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k., por nuk ka ngritur pretendimin si më sipër, në lidhje me kontratën me landfillin. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes “V.A.L.E Recycling” sh.p.k, nuk e ka ezauruar shkallën e parë të ankimit në përputhje me parashikimet e nenit 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në lidhje pretendimin e mësipërm për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Për këto arsye, KPP nuk mund të shqyrtojë pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimes për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. për sa kohë që, ky pretendim nuk është ezauruar, duke plotësuar kushtet formale, që në ankesën e parë të paraqitur pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k., fakt për të cilin ky i fundit ishte në dijeni që në vlerësimin e datës 18.05.2020.

Sa më sipër, pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimes nuk merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., i cili kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. me arsyetimin se “*OE MEDI TEL nuk ka mundesi reale te justifikojte vleren e ofertes anomalisht te ulet te paraqitur prej tij. Duke e njohur mire tregun dhe analizen e detajuar te kostove per realizimin e ketij sherbimi, ne kemi vezhguar dhe studiuar edhe modalitetet me te cilat operon OE MEDI-TEL. Nga keto vezhgime, na rezulton se OE MEDI-TEL, nuk ka kushte favorizuese si tonat, ne lidhje me elementet ekonomike si p.sh. (i) vlerat favorizuese ne fumizimin me materiale per shkak te rritjes se volumit te shitjeve MEDI-TEL ne fakt ka pesuar renie ne volumin e shitjeve, sic mund te shikohet ne bilancet e depozituara dhe te pasqyruara ne faqen eeb te QKR); (ii) nuk e ben servisimin teknik te automjeteve ne stabilimentin e vet dhe me burimet e veta teknike dhe njerezore por tek te trete, cka i shkakton kosto me te larta se tonat; (iii) kostot e karburantit i ka me te larta, pasi ndryshe nga ne nuk ka bot dhe pike fumizimi ne stabilimentin e vet qe mundeson perfitimin e karburantit me cmim favorizues; etj. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, rezulton se barra e proves mbi argumentin e ofertes anomalisht te ulet i perket operatorit ekonomik, oferta e te cilit eshte konstatuar anomalisht e ulet nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave. [...], Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.3.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 10 “Specifikimet teknike”, parashikohet si më poshtë vijon:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Specifikimi i Materijaleve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimeve ne lidhje me to:

Skicimet, parametrat teknik etj, specifikimi i materijaleve,, përshkrimi i kerkesave te zbatimit te sherbimit ne lidhje me to.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, dhe Ligjit nr. 156/2013 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, Ligjin Nr. Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr. 99 datë 18.02.2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve” si mëposhtë do të gjeni specifikimet teknike .

Specifikime teknike të përgjithshme për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, anatomike të lëngshme dhe të ngurta:

- 1. Operatori Ekonomik nuk duhet të veprojë asnjëherë pa praninë e përfaqësuesve të Sektorit të Hotelerisë (Inspektori Sanitar). Për kryerjen e shërbimeve operatori ekonomik duhet të paraqesë situacionin përmbledhës, dokumentat dhe faturat shoqëruese për sa është realizuar, në periudha kohore mujore përkatëse si dhe proces-verbalin për shërbimin e kryer të firmosur mes dy palëve (të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të Sektorit të Hotelerisë).*
- 2. Mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike të lëngshme dhe të ngurta, duhet të trajtohen në impiant, i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi, sipas përcaktimeve të mëposhtme ne lidhje me to.*

3. *Trajtimi duhet të realizohet me grirje dhe sterilizim, dhe mbetjet të bëhen të parrezikshme. Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e inebruar te mbetjeve" udhezuesin kombetar te Administrimit te Sigurte te mbetjeve Spitalore, VKM nr. 798 date 29/09/2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore", Shtojca 3: Metoda per trajtimin dhe asgjесimin 1. Incenerim; 2. Autoklavim: a) Presion, b) Presion-avull, c) Presion-avull-copetim; 3. Sterilizim me mikrovale; 4. Sterilizim-UV; 5. Trajtim kimik/dizinfektim: a) me shkumes te kloruar, b) me klor aktiv (klor te lire), c) me peroksid hidrogjeni (H2O2), d) me glutinimin e proteinave nepermjet perdorimit te acideve, e) me ozon (O3), Ligjin Nr. 9537 date 18.05.2006 "Per admnistrimin e mbetjeve spitalore".*

Standardet teknike per incenerimin e mbetjeve spitalore perfshijne standardet e percaktuara ne tabelen 6.1 "Krematori" te vendimit te Keshillit te Ministrave nr.435, date 12.9.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republikene e Shqipërisë".

Ndalohe djegia e mbetjeve te rrezikshme ne impiante me fuqi kalorifike me te vogel se 350 kE.

Inceneratorët që përdoren për trajtimin e mbetjeve spitalore, duhet të jenë të pajisur me siguresa ose pajisje të tjera kontrolli, për të ndaluar funksionimin e impiantit djegës nëse nuk janë plotësuar kushtet e percaktuara ne paragrafin e mesiperme 8.10. Ne rast se arrihet një temperaturë me e ulët, impianti duhet të jetë i pajisur me djegës ndihmës, të cilët, duke mos llogaritur sasinë e nxehtësisë së mbetjeve, janë ne gjendje të mbajnë ne mënyrë të pavarur një temperaturë minimale prej 700°C. Përgjegjësi i inceneratorit përgjigjet për:

- Monitorimin dhe regjistrimin e vazhdueshëm të dhomave primare dhe sekondare të djegies;

- Ruajtjen e të dhënave të monitorimeve të kryera për një periudhë shtatëvjeçare.

Të gjitha mbetjet spitalore që mund të digjen, duhet të shndërrohen nga inceneratori në hi që nuk përkon me formën e mbetjeve para djegies. Ky hi që rezulton nga djegia, të paktën një herë çdo tre muaj analizohet duke përdorur përzierje kampionaturash të rastit për përmbajtjen e karbonit organik total dhe çdo vit analizohet për përmbajtjen e plumbit, merkurit, kaliumit dhe metaleve të rënda. Hiri që rezulton nga djegia nuk duhet të ketë më shumë se 5% karbon (minimalisht 95% djegie).

Mbetja nga djegia ose hiri që përftohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore është mbetje e ngurtë dhe asgjësohet në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9010, date 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta".

Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përshihë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.

Operatori ekonomik duhet të instalojë një frigorifer (banak frigoriferik), tek ambjenti që do të përcaktojë SUOGJ "Koco Gliozheni", me kapacitet 200- 250 kg, dhe temperaturë ngrirje deri minus -18 gradë celsius, për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme, deri në momentin e transportimit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit.

Operatori ekonomik do të furnizojë çdo herë që evadon mbetje të rrezikshme spitalore Autoritetin Kontraktues me kontenierë kartoni dhe/ose plastike sipas VKM 798 date 29.09.2010 "Mbi mbetjet spitalore", pikat 8/4 dhe 8/5 të kreut III, të certifikuar CE, shoqëruar me certifikatën përkatëse si dhe bazuar ne "Udhezuesin Kombetar per administrimin e sigurt te Mbetjeve Spitalore".

Volumi i kontenitoreve duhet të jetë:

Përafërsisht 3 L – 6 L (per Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta)

Kontenieret dhe qeskat duhet të jene me ngjyre të verdhe dhe logon e firmes fituese. Te gjithë kontenieret që perdoren nga spitali duhet të merren nga firma dhe të behet dezinfektimi it yre prej saj. Amballazhi duhet të jete sipas percaktimeve të bera ne VKM-ne Nr. 798, dt. 29.09.2010 “Per administrimin e mbetjeve spitalore” si dhe Udhezuesit kombetar “Administrimi I Sigurt I mbetjeve Spitalore.

- 1. Operatori ekonomik do të evadojë mbetjet e rrezikshme spitalore dy herë në javë, përkatësisht ditën e hënë dhe të enjte.*
- 2. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i mirë i frigoriferit dhe i ambjentit ku janë magazinuar mbetjet e rrezikshme spitalore. Kjo do të pasqyrohet nga specialisti i hidrokлавës në provecverbalin përkatës të tyre.*
- 3. Transporti i mbetjeve nga ambjenti i magazinimit, në SUOGJ “Koco Gliozheni” deri në impiantin e trajtimit do të bëhet me mjet të posaçëm të sipërmarrësit të identifikuar dhe me amballazhim përkatës, në përputhje me standartet e OBSH, për mbetje të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme.*
- 4. Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht dy automjetet te posacem*, te pajisur me sinjalistikën perkatëse per transport mbetjesh te rrezikshme spitalore dhe te pajisur me leje per transportin e mbetjeve te rrezikshme spitalore, ne pronesi apo me qira, të vërtetuar me certifikatë pronësie, dhe te shoqeruar me kontrate qiraje kur mjete është i marre me qira(ne perputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcen nr. 4 te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhezuesin Kombetar “Administrimi i sigurt i mbetjeve spitalore” seksioni 9.3.3 (automjetet anijet e grumbullimit).*
- 5. Mbetjet e vendosura në kontenierët përkatës do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve (peshorja do të ofrohet nga operatori fitues dhe duhet të shoqërohet me akt kolaudimi nga autoritetet përkatëse), ku do të shkruhen në faturë sasia e peshuar, pa përfshirë kutinë e amballazhimit të transportit, në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të kësaj fature do mbeten në SUOGJ “Koco Gliozheni”, dhe një kopje e merr përfaqësuesi i firmës. Ky proces, shkruhet dhe në rregjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.*
- 6. Ne cmimin e deklaruar nga operatori do të përfshihen: kontenitorët, amballazhet, që do të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, gjithashtu në cmim përfshihen edhe grumbullimi, transporti, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore. Këto (kontenitorët, amballazhet) duhet të përmbushin standartet e përcaktuara në VKM 798 datë 29/09/2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.*
- 7. Mbetjet e vendosura në kontenierët përkatës do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve (peshorja do të ofrohet nga operatori fitues dhe duhet të shoqërohet me akt kolaudimi*

nga autoritetet përkatëse), ku do të shkruhen në faturë sasia e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambllazhimit të transportit, në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të kësaj fature do mbeten në SUOGJ “Koco Gliozheni”, dhe një kopje e merr përfaqësuesi i firmës. Ky proces, shkruhet dhe në rregjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.

8. Ne cmimin e deklaruar nga operatori do të përfshihen: kontenitorët, ambllazhet, që do të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, gjithashtu në cmim përfshihen edhe grumbullimi, transporti, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore. Këto (kontenitorët, ambllazhet) duhet të përmbushin standartet e përcaktuara në VKM 798 datë 29/09/2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
9. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i mirë i frigoriferit dhe i ambientit ku janë magazinuar mbetjet e rrezikshme spitalore. Kjo do të pasqyrohet nga specialisti i hidrokлавës në provecverbalin përkatës të tyre.
10. Transporti i mbetjeve nga ambienti i magazinimit, në SUOGJ “Koco Gliozheni” deri në impiantin e trajtimit do të bëhet me mjet të posaçëm të sipërmarrësit të identifikuar dhe me ambllazhim përkatës, në përputhje me standartet e OBSH, për mbetje të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme.
11. Për transportin e mbetjeve të disponojë minimalisht dy automjetet te posacem*, te pajisur me sinjalistiken perkatese per transport mbetjesh te rrezikshme spitalore dhe te pajisur me leje per transportin e mbetjeve te rrezikshme spitalore, ne pronesi apo me qira, të vërtetuar me certifikatë pronësie, dhe të shoqëruar me kontratë qiraje kur mjeti është i marre me qira. Mjeti i kërkuar si më sipër, duhet të jetë sipas pershkrimit: “plotësisht i mbyllur që ka një kabinë të ndarë, ose një automjet unitar në të cilën kabina e shoferit është e veçuar plotësisht nga ndarja ku vendosen mbetjet nga një paret i mbyllur i fiksuar”. Mjetet duhet të jenë të pajisura me dokumentin e lejes higjieno sanitare, sic është përcaktuar në Udhezuesin Kombëtar.
12. Të gjitha detyrimet ligjore për zbatimin e VKM 798 datë 29/09/2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” nga momenti që dorëzohen të përfaqësuesi i firmës janë në ngarkim të operatorit ekonomik.
13. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik të një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike. Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) Numrin e dokumentit të dorëzimit;
 - b) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;
 - c) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;
 - ç) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);
 - d) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;
 - dh) Përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasi të respektive;

e) Hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimit e tyre.

14. Marrësi në dorëzim, kur refuzon një transfertë mbetjesh të rrezikshme, i tregon transferuesit arsyet e refuzimit.

15. Çdo person, që angazhohet në dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme, ruan dokumentacionin e transferimit për një kohë prej të paktën 3 vjetësh nga data kur fillon dorëzimi dhe ua vë ato në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Inspektoratit për Mjedisin, pas paraqitjes së kërkesës së tyre me shkrim. Dokumentacioni përmban të paktën kopje të dokumentit të dorëzimit, kopje të dokumentit të konfirmimit dhe informacion për dorëzimet e refuzuara.

16. Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore duhet të respektohen rregullat dhe kërkesat të cilat lejojnë transportin e sigurt të mbetjeve anatomike të lëngëta dhe të ngurta, dhe të parandalohen rrjedhjet apo derdhjet e tyre.

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

<i>COD</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi</i>	<i>Vlera</i>
180102	<i>Pjese te trupti dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut, rezervat e gjakut (pervec 180103)</i>	<i>kg</i>	<i>2550</i>		
<i>180101 dhe 180103</i>	<i>Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta, mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet</i>	<i>kg</i>	<i>21450</i>		
<i>TOTAL</i>	<i>Mbetje te rrezikshme spitalore</i>	<i>kg</i>	<i>24000</i>		

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.3.2. Gjithashtu, në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: “Eliminim Mbetjesh te Rrezikshme Spitalore” ”

Afatet e ekzekutimit: 12 MUAJ NGA NENSHKRIMI I MARREVESHJES KUADER

III.3.3. Ndërsa, në shtojcën 13 “Termet e Referencës”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Eleminim Mbetjesh te Rrezikshme Spitalore”

Detyrat:

1. *Mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike të lëngshme dhe të ngurta, duhet të trajtohen në impiant, i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit për kryerjen e këtij shërbimi.*
2. *Trajtimi duhet të realizohet sipas kodeve perkatëse të mbështetura në VKM 798 datë 29.09.2010 kjo e përcaktuar në shtojcën Nr. 3 e cila përcakton metodat për trajtimin dhe asgjësimin:*
 - *Incenerim*
 - *Autoklavim a) presion, b) presion avull, c) presion, avull, copetim*
 - *Sterilizim me mikrovalë*
 - *Sterilizim-UV*
 - *Trajtim Kimik/Dizifektim a) me shkumës të kloruar, b) me klor aktiv (klor të lire), c) me peroksid hidrogjeni (H₂O₂), d) me glutinimin e proteinave nepermjet perdorimit të acideve, e) me ozon (O₃)*
3. *Operatori ekonomik duhet të instalojë një frigorifer (banak frigoriferik), tek ambjenti që do të përcaktojë SUOGJ “Koco Gliozheni”, me kapacitet 200- 250 kg, dhe temperaturë ngrirje deri minus -18 gradë celsius, për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme, deri në momentin e transportimit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit.*
4. *Operatori ekonomik do të furnizojë çdo herë që evadon mbetje të rrezikshme spitalore Autoritetin Kontraktues me kontenierë kartoni sipas VKM 798 datë 29.09.2010 “Mbi mbetjet spitalore”, pikat 8/4 dhe 8/5 të kreut III, të certifikuar CE, shoqëruar me certifikatën përkatëse. Volumi i kontenitoreve duhet të jetë:*

Përafërsisht 40-60 L

Përafërsisht 3 L – 6 L (per Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta)
5. *Operatori ekonomik do të evadojë mbetjet e rrezikshme spitalore dy herë në javë, përkatësisht ditën e hënë dhe të enjte.*
6. *Mbetjet e vendosura në kontenierët përkatës do të peshohen në praninë e përfaqësuesve të dy palëve (peshorja do të ofrohet nga operatori fitues dhe duhet të shoqërohet me akt kolaudimi nga autoritetet përkatëse), ku do të shkruhen në faturë sasia e peshuar, pa përfshirë kutinë e ambalazhimit të transportit, në tre kopje dhe do nënshkruhet nga sipërmarrësi dhe përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor. Dy kopje të kësaj fature do mbeten në SUOGJ “Koco Gliozheni”, dhe një kopje e merr përfaqësuesi i firmës. Ky proces, shkruhet dhe në rregjistrin e mbetjeve spitalore të rrezikshme.*

7. *Ne cmimin e deklaruar nga operatori do të përfshihen: kontenitorët, ambllazhet, që do të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, gjithashtu në cmim përfshihen edhe grumbullimi, transporti, trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme spitalore. Këto (kontenitorët, ambllazhet) duhet të përmbushin standartet e përcaktuara në VKM 798 datë 29/09/2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore".*
8. *Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i mirë i frigoriferit dhe i ambjentit ku janë magazinuar mbetjet e rrezikshme spitalore. Kjo do të pasqyrohet nga specialisti i hidroklaivës në provecverbalin përkatës të tyre.*
9. *Transporti i mbetjeve nga ambjenti i magazinimit, në SUOGJ "Koco Gliozheni" deri në impiantin e trajtimit do të bëhet me mjet të posaçëm të sipërmarrësit të identifikuar dhe me ambllazhim përkatës, në përputhje me standartet e OBSH, për mbetje të rrezikshme spitalore anatomike të ngurta dhe të lëngshme.*
10. *Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik te një tjetër, shoqërohen me dokument dorëzimi, i cili është i vlefshëm edhe në formë elektronike.*

Dokumenti i dorëzimit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) Numrin e dokumentit të dorëzimit;*
- b) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të dorëzuesit;*
- c) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transportuesit;*
- ç) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të vendit të destinacionit të mbetjes së rrezikshme (të marrësit në dorëzim);*
- d) Emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të krijuesit të mbetjeve;*
- dh) Përshkrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë listën e kodeve të mbetjeve dhe sasisë respektive;*
- e) Hollësi për përbërësit kimikë apo biologjikë të mbetjeve të rrezikshme dhe përqendrimit e tyre.*

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: SUOGJ "Koco Gliozheni" Tirane

III.3.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

III.3.5. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon se "[...]

1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

III.3.6. Në nenin 66, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit.

Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së”.

Sa më sipër referuar, nëse një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, ku thuhet se:

“1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur.

Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.3.7. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.3.8. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, oferta ekonomike e tij në zbatim të nenit 66 pika 5 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar

informacion të detajuar operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. në zbatim të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 21.08.2020, me shkresën me nr. 883 prot., autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. informacion mbi ofertën anomalisht të ulët, sipas të cilës është kërkuar (citojmë) “[...] ... *Ju informojmë se KVO pranë autoritetit kontraktor SUOGJ “Koço Gliozheni” pasi u njoh me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr.289/1 prot., datë 30.07.2020, me Nr. 838 Prot., datë 05.08.2020 dhe bazuar në process-verbalin e mbajtur me datë 05.08.2020 nga KVO iu bëjmë me dije se në lidhje me objektin e prokurimit “Eliminimi i mbetjeve të rrezikshme” për vitin 2020, me Ref-49949-02-10-2020, me fond limit 7.279.200 lekë pa TVSH, dhe pas rivlerësimit në sistemin elektronik vendosi: Bazuar në nenin 56 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, tiu kërkojë operatorëve ekonomik të kualifikuar si oferta ekonomike te suksesshme përkatësisht*

1. *Medi Tel sh.p.k. me ofertë me vlere 4.392.000 leke pa tvsh*
2. *V.A.L.E Recycling me ofertë me vlere 4.680.000 lekë pa tvsh*

Të sjellin pranë SUOGJ “Koço Gliozheni” brenda datës 26.08.2020 ora 10 argumentin e ofertës ekonomike të paraqitur nga ana juaj në sistemin elektronik të datës 18.05.2020 me postë elektronik të datës 18.05.2020, me postë elektronike dhe informacion me shkrim sipas nenit 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”

- a) *anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) *zgjdhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) *origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) *zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

2. *Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.*

III.3.9. *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në datën 21.08.2020 pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin me lëndë “Argumentim oferte ekonomike” në të cilën ka paraqitur një përshkrim dhe interpretim narrativ të ofertës së tij. Konkretisht, operatori ekonomik ankimes ka argumentuar: Referuar parashikimeve ligjore te prokurimit publik, konkretisht neni 56 i LPP ku kerkohet qe Oferta anomalisht e ulet: 1. Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per. a) anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruarat b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi.c) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me*

ofertuesin dhe ne baze u informacionit te paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzoje oferten, kur edhe pas shqyrtimit te infomacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj”, sqarojme se oferta e paraqitur nga Medi -Tel Shpk, ne kete procedure prokurimit, eshte plotesisht e rregullt, dhe ne perputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislatori ne LPP dhe RrPP.

Se pari sqarojme se oferta e paraqitur ndaj Autoritetit tuaj kontraktor, eshte preferenciale, e dedikuar vetem per autoritetin tuaj, duke marre parasysh situaten aktuale ne te cilen gjendet vendi jone si pasoje e pandemise globale te shpallur Covid 19;

Ne DST, nga AK kerkohet asgjesimi I mbetjeve si me poshte:

COD	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
180102	Pjese te trupti dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut, rezervat e gjakut (pervec 180103)	kg	2550		
180101 dhe 180103	Bisturite, shiringa, instrumente te mprehta, mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet	kg	21450		
TOTAL	Mbetje te rrezikshme spitalore	kg	24000		

Sipas perlllogaritjes bruto te bere nga specialistet tone, rezulton se cmimi I perafert per kilogram (kg) nga Autoriteti juaj Kontraktor, eshte rreth 303,3 (treqind e tre presje tre) Leke pa TVSH; Sic tham me siper, duke u ndodhur ne situaren e pandemise globale te Covid - 19, e cila ka perfshire edhe vendin tone, pasojat e te cilit po ndihen rende ne ekonomi, ne si operator ekonomik pjesemarre ne kete procedure prokurimi, vendosem qe te ofrojme cmim preferencial ne kete procedure, cmim i cili garanton plotesisht permbushjen e kontrates duke zbatuar edhe parashikimet ligjore te nenit 46 te LPP.

Ne jemi paraqitur ne kete procedure prokurimit, me cmim preferencial per kilogram 183 (njqind e tetedhjete e tre) leke pa TVSH;

Nga perlllogaritja e kosos se sherbimlt, vleresojme ne rastin e shpalljes fitues ne kete procedure prokurimit, kostot e sherbimit posaeerlsht per kete procedure, te perlllegaritura per 1000 kg, jane:
- Shpenzime Karburanti:

- Per asgjesimin e 1000 kg mbetjesh objekt prokurimi, ne perputhje me grafikun e sherbimit, termat e references dhe afatet e levrimit ne DST, parashikojme transportin e mbetjeve per nje hark kohor prej 2 javesh, ne rreth 4 (kater) rruge, X 7 Litra karburant l llojit Diesel, per cdo rruge, X 127.5 leke per liter= $4 \times 7 \times 127.5 = 4'083$ (kater mije e tetedhjete e tre) Lek pa TVSH;

- Incenerimi I Mbetjeve:

Referuar katalogut te prodhuesit dhe skedes telcnike te Inceneratorit MediBum30, te cilin ne e disponojrme sipas Lejes se Mjedisit te paraqitur ne SPE per kete procedure prokurimi, kapaciteti kufi per trajtimin e ketyre mbetjeve eshte: 30 kilogram per cikel, Kohezgjatja e nje cikli te plote

varion nga 30 - 40 minuta. Per asgjesimin e 1000 kg, nevojiten rreth 36 cikle te plota asgjesimi, e perkthyer ne rreth 20 ore pune te inceneratorit. Konsumi i energjise per nje cikel te plote I cili zgjat rreth 30 rrinuta eshte rreth 7 (shtate) litra, Per 20 ore pune, nevojiten rreth 280 litra karburant, $X 146 \text{ leke per liter} = 20 \text{ ore pune} \times 14 \text{ litra} \times 146 \text{ leke per liter} = 40'880$ (dyzet mije e teteqind e tetedhjete) lek pa TVSH;

- Konsumi I energjise elektrike:

Referuar konsumit te faturuar te energjise elektrike, rezulton se konsumi I perkthyer ne Leke eshte rreth 100'000 (njqind mije) Lek ne muaj. Referuar kohezgjatjes se trajtimit te 1000 kg qe eshte per 1/2 muaj, konkretisht per 14 dite (dy jave), konsumi I energjise elektrike eshte rreth 50,000 (pesedbjete mije) Lek pa tvsh;

- Ambalazhimi I mbetjeve (njeperdorimsh):

Per ambalazhimin e sasise se mbetjeve prej 1000 kg, nevojiten:

- Rreth 60 kosha plastik te permasave 5 L db 12 L, per te cilet ne si operator ekonomik jemi distributor te prodhuesit, dhe kostoja per 1 kosh, duke qene se nuk aplikohen tarifa shtese pervec kosos se blerjes, transportit dhe zhdoganirnit direct nga prodhuesi, eshte rreth 120 leke pa tvsh; Konkretisht 60 kosha $\times 120 \text{ leke per kosht}$ (perlllogaritje mesatare) = 7,200 (shtatemije e dyqind);
- Rreth 125 cope qese plastike te verdha sipas percaktimeve te VKM 798/2010, me cmim per cope 6.5 (gjashte presje pese) Lek pa tvsh, e perkthyer ne $125 \times 6,5 = 812 \text{ leke pa tvsh}$.
- Rreth 125 Kuti kartoni sipas percaktimeve te VKM 798/2010, me cmim per cope 110 (njqind e dhjete) Lek pa tvsh, e perkthyer ne $125 \times 110 = 13'750 \text{ leke pa tvsh}$.

Punetoria:

- Per ekzekutimin e kontrates per kete procedure prokurimit, kerni perlllogaritur nevojen e nje stafit te shoqerise prej:

- 1 (nje) shofer me page bruto prej 54'200 lek;
- 1 (nje) punonjes te autoklaves/inceneratorit prej 54'200 lek;

Nga perlllogaritja, kosto e punetorise per ekzekutimin e kesaj kontrate, per 14 dite, eshre 54'200 (pesedhjete e kater mije e dyqind) Lek.

- Depozitimi i mbetjeve ne Landfill, sipas kontrates koncensionare eshte rreth 60 Euro per 1000 kg, konkretisht $60 \text{ EX } 123 = 7'380$ (shtatemije e treqind e tetedhjete) Lek pa tvsh.

Nga perlllogaritja, kosto totale e asgjesimit te sasise se mbetjeve prej 1000 kg eshte rreth 177'797 (njqind e shtatedhjete e shtate mije e shtate qind e nentedhjete shtate) lek pa tvsh.

Oferta jone eshte 183 leke per kilogram (pa tvsh), pra 183'000 [njqind e tetedbjete e tre mije] leke pa tvsh per 1000 kg. Me nje fitim minimal prej 5,203 (pese presje dyqind e tre) pra rreth 52 (pesedhjet e dy) lek te vjetra per kilogram.

Pra sic sqaruar me siper, shoqeria jone, duke marre shkak nga situata aktuale ne vendin tone, e cila dita dites po perkeqesohet me raste te cilat po rriten, si dhe duke u nisur nga fakti qe bilancet e kompanise jane positive sic mund ta verifikoni lehtesisht ne dokumentacionin e administruar ne SPE, ka ofruar cmim preferencial, me nje fitim sa me minimal te mundshem ne kete procedure prekurimi.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin, lutem qe bashkelidhur te gjeni dokumentacionin tekniko-Ligjor qe verteton sa me siper, Bashkangjitur:

Fature e Landfillit

III.3.10. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor konstatohet se, operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k, për argumentimin e ofertës së tij si ofertë anomalisht e ulët, përveç të tjerave ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje nr. 56158, datë 22.05.2020 për karburantin, me shitës Europetrol Durrës Albania sh.a. dhe blerës “Medi – Tel” sh.p.k.

- Faturë tatimore shitje nr. 87962835, datë 12.06.2020, me shitës Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. dhe blerës “Medi – Tel” sh.p.k.

- Faturë tatimore Prill 2020 lëshuar nga OSHEE.

- Listëpagesat e Muajit Qershor 2020 të shoqërisë “Medi Tel” sh.p.k.

- Licencë LN-9352-11-2019, Kodi III.2.B “Grumbullim, transportim, ruajtje, trajtim dhe asgjësim I mbetjeve të rrezikshme spitalore”, në emër të subjektit “Medi Tel”, (shoqëruar me Akt-Miratimin, të lëshuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit).

Sa më sipër, operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. ka sqaruar dhe argumentuar në shkresën e mësipërme, se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 56 të ligjit për prokurimin publik. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. në përmbushje të parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar, janë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përshkrime narrative si edhe dokumentacion shoqërues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik të ofertës së dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.3.11. Përpara se të marrë në analizë materialin justifikues/argumentues të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson ti referohet edhe praktikës e legjislacionit të BE mbi çështjen. Kështu, në çështjen precedent *Lombardini and Mantovani* (C-285/99 [2001] ECR I-9233), Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg) u shpreh se “*Cilido qoftë legjislacioni, autoritetet kontraktore janë të detyruara të identifikojnë dhe hetojnë Ofertat Anomalisht të Ulëta, pavarësisht nëse ata kanë për qëllim t’i skualifikojnë ato*”. Kjo qasje mbështetet nga fakti se, Komisioni European, ndërsa draftonte Direktivën përkatëse, kishte përpara tij Opinionin e Komitetit Ekonomik e Social të Këshillit European (CES 515/2001), i cili propozonte se: “*Në rast të një oferte anomalisht të ulët ... duhet të specifikohet se autoritetet kontraktore duhet t’i hetojnë ofertat të cilat duken se janë anomalisht të ulëta. Duhet të përcaktohet qartësisht se ofertat në fjalë do të refuzohen nëse nuk do të paraqitet një justifikim i përshtatshëm*”. Ky parashikim është parë nga këndvështrimi i mbrojtjes së autoriteteve kontraktore nga ofertues që do të fitonin kontrata përmes çmimesh të pambështetura, me rrezik potencial për të rinegociuar fondin limit pak kohë pas lidhjes së kontratës; keqpagimin e punëtorisë apo të nënkontraktorëve, apo përdorimin e materialeve të cilësisë së ulët. Komisioni European ka deklaruar se ky është një problem i hasur posaçërisht në industrinë e ndërtimit. Një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar.

III.3.12. Duke u rikthyer në çështjen tonë, nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k.

me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar dokumenti “Argumentim oferte ekonomike” në të cilën ka paraqitur një përshkrim dhe interpretim narrativ të ofertës së tij.

III.3.13. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit justifikon ofertën e paraqitur nga ky i fundit në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.3.14. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. përmbush katër kushtet kumulative të kërkuar nga ligji i posaçëm në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike anomalisht të ulët. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka rezultuar anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

III.3.15. Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Medi - Tel” sh.p.k. është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori është e rregullt dhe duhet të kualifikohet nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-56670-04-23-2020, me objekt “*Shërbim Eleminim mbetjesh te rrezikshme - Marrëveshje Kuadër me nje operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*”, me fond limit 7.279.200 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1103 Protokolli

Datë 11.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri